



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 154/16 Prot.

Tiranë, më 28/2 /2014

REKOMANDIM

Nr 14 ,datë 28/02/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Byroja Shqiptare e Sigurimit" (BSHS) Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhrin nr.22 datë 04/02/2014 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "Byroja Shqiptare e Sigurimit" me objekt: "Zbatimi nga ana e kontrolluesit "Byroja Shqiptare e Sigurimit" i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave personale" i ndryshuar, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij në fushën e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit".

Kontrolli administrativ ka filluar kryesisht nga zyra e Komisionerit dhe kontrolluesi është njoftuar paraprakisht për kryerjen e kontrollit. "Byroja Shqiptare e Sigurimit" në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, është kontrollues publik, përgjegjës për administrimin e "fondit të kompensimit" dhe "kartonit jeshil" në fushën e sigurimeve në sektorin e transportit. "Byroja Shqiptare e Sigurimit" mbledh, përpunon, ruan të dhëna personale gjatë procedurave të krijimit të dosjeve për subjektet e të dhënave personale punonjës dhe individët në rastet e çeljes së praktikave të dëmshpërblimit dhe praktikave të rimbursimit, si dhe trajtimit dhe përpunimit në rrugë elektronike në sistem pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF).

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ dhe provat e administruara vëren se:

1. Kontrolluesi kryen publikimin në faqen zyrtare të tij në internet www.insurers-al.org, të "listës së debitorëve ndaj Byrosë Shqiptare të Sigurimit, për dëme të shkaktuara në thyerje të ligjit, në rastet pa siguracion për automjetin", në këtë rast:

- është shkelur neni 5/1/c i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, pasi ky publikim kryhet jo në përputhje me qëllimin me të cilat kontrolluesi mbledh, përpunon dhe ruan të dhënat personale.

- është shkelur neni 6/1/a i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, pasi kontrolluesi nuk ka dokumentuar pëlqimin e shprehur të subjekteve të të dhënave personale lidhur me këtë publikim.
- është shkelur neni 18 i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, pasi kontrolluesi nuk kryen informimin e subjekteve të të dhënave, lidhur me këtë publikim.
- janë shkelur nenet 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, pasi duke publikuar këtë listë, kontrolluesi nuk realizon ruajtjen e të dhënave personale, si dhe nuk ruan konfidencialitetin e të dhënave personale .

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se kontrolluesit mund të publikojnë të dhëna personale vetëm duke zbatuar parimet dhe kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, para së gjithash kontrolluesit duhet të kujdesen që të dhënat të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim. Pëlqimi është çdo deklaratë me shkrim e subjektit të të dhënave personale, e dhënë me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen. Subjektet e të dhënave personale duhet të japin pëlqimin e tyre për rastet e publikimit nga kontrolluesi i të dhënave të tyre personale, nëse ky publikim nuk është detyrim ligjor i kontrolluesit. Kontrolluesit duhet të informojnë subjektet e të dhënave nëse ato do të bëjnë publikim të të dhënave, si dhe të marrin masa që ky publikim të garantojë sigurinë dhe konfidencialitetin e tyre. Të dhëna personale duhet të jenë të përpunuara në mënyrë të drejtë për qëllimet e specifikuar dhe në bazë të pëlqimit të personit të interesuar, ose në bazë legjitime të përcaktuar me ligj.

2. Kontrolluesi nuk kryen informimin e subjekteve të të dhënave personale, mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, përhapjes, ruajtjes dhe masave të sigurisë që ai ka marrë për të dhënat personale të tyre:

- Gjatë mbledhjes në tërësi të të dhënave personale në rastet e çeljes së praktikave të dëmshpërblimit dhe praktikave të rimbursimit, si dhe trajtimit dhe përpunimit në sistemin elektronik të tyre.
- Gjatë procesit të transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale brenda dhe jashtë vendeve të BE-së, për kategorinë e subjekteve të të dhënave “individë”, shkaktarë dhe përfitues dëmsh.
- Në faqen e tij në internet www.insurers-al.org, në të cilën nuk ka publikuar “politikat e privatësisë” (paketë rregullash) me qëllim informimin e subjekteve që vizitojnë këtë faqe mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Në këtë rast është shkelur neni 18/1 i ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga kontrolluesit është një detyrim shumë i rëndësishëm në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit në respekt të ligjit i të dhënave personale. Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur. Kur të dhënat mblidhen nga subjektet e interesuar, informacioni mund të jepet në kohën e grumbullimit të të dhënave. Gjithashtu mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale përmes përdorimit të faqes të internetit duhet të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private.

3. Kontrolluesi ka plotësuar gabim disa nga rubrikat e njoftimit të dorëzuar në zyrën e Komisionerit, në rubrikën 6.1 kontrolluesi nuk ka specifikuar qartë qëllimet e përpunimit; në rubrikën 10.1 nuk ka deklaruar qartë masat e sigurisë dhe politikat e ruajtjes së privatësisë. Në këtë rast janë shkelur nenet 21-26 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar lidhur me njoftimin.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se deklarimi i qëllimit të përpunimit do të konsiderohet nga më të rëndësishmet, pasi përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë një proces i bazuar në ligj dhe i drejtë, duke garantuar mbrojtjen maksimale të subjekteve të këtyre të dhënave. Për të realizuar njoftimin në lidhje me qëllimin kontrolluesit duhet të kenë vëmendjen maksimale për të arritur në konkluzionin se përpunimi i të dhënave bëhet për një qëllim apo për disa qëllime. Qëllimi i përpunimit lidhet detyrimisht edhe me parimet e përcaktuara në nenet 5-9 të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me qëllimin apo me qëllimet. Në njoftim kontrolluesit deklarojnë një përshkrim të përgjithshëm të masave për sigurinë e të dhënave personale, nëse kontrolluesi ka hartuar, miratuar dhe zbaton rregulla konkrete të cilat bëjnë të mundur garancinë e sigurimit të të dhënave që përpunohen nga ana e tyre. Faktimi i një oficeri (*ose personi të ngarkuar*) sipas nenit 3/14 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, për mbrojtjen e të dhënave nga kontrolluesit, si dhe regjistrimi i tyre pranë KMDP shton besimin dhe transparencën e procesit të përpunimit të të dhënave personale nga këto kontrollues.

4. Kontrolluesi nuk ka të hartuar, (*apo të ketë të përfshira në rregulloren e tij*) rregulla të brendshme, për mbledhjen, ruajtjen, përpunimin, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, duke shkelur nenet 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se hartimi i rregulloreve është një pjesë e rëndësishme e masave të sigurisë që në tërësi zbaton kontrolluesi, prandaj është shumë e rëndësishme që ju si kontrollues të hartoni rregullore të veçantë për të përcaktuar rregulla për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Në rregullore duhet të përcaktohen nivelet e përdoruesve, të drejtat e tyre, aksesit etj, si dhe rregulla lidhur me konfidencialitetin e të dhënave personale. Përmirësimi dhe plotësimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative :

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 5, 6, 18, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar:

- Të ndalohet publikimi "*listës së debitorëve ndaj Byrosë Shqiptare të Sigurimit , për dëme të shkaktuara në thyerje të ligjit, në rastet pa siguracion për automjetin*" në faqen zyrtare www.insurers-al.org, të bëhet e palexueshme (*hidden*) kjo listë, si dhe të mos jepet për publikim në medien e shkruar apo vizive.

2. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

- Të bëhet informimi i subjekteve të të dhënave personale gjatë mbledhjes në tërësi të të dhënave personale në rastet e çeljes së praktikave të dëmshpërblimit dhe

praktikave të rimbursimit, si dhe trajtimit dhe përpunimit në rrugë elektronike të të dhënave personale, mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim, përhapjen e të dhënave personale dhe sigurinë e tyre

- Të bëhet informimi i subjekteve të të dhënave personale gjatë procesit të transferimit ndërkombëtar të të dhënave personale brenda dhe jashtë vendeve të BE-së, për kategorinë e subjekteve të të dhënave "individë", shkaktarë dhe përfitues dëmsh, mbi mënyrën e mbledhjes, përpunimit, ruajtjes, të drejtën për akses, të drejtën për korrigjim, përhapjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
- Në faqen tuaj në internet www.insurers-al.org, të publikohen në një rubrikë të veçantë "politikat e privatësisë" (paketë rregullash), me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. Disa nga këto parime do t'i gjeni në Opininion "Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat" publikuar në faqen zyrtare të KMDP-së www.kmdp.al.

3. Në zbatim të neneve 21-26 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar të behet përditësimi i njoftimit duke respektuar dhe kërkesat e këtij Rekomandimi. Informacione të rëndësishme lidhur me njoftimin mund të gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë.

4. Në zbatim të neneve 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të hartohet rregullore e brendshme lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale. Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë.

5. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi.

6. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

7. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, sipas të cilit.. "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI
FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

